

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 232/20

Nr. i fq. / Br. sh -02-

Data: / Datum 26.02.2020

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040, nenin 17 pika 2 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 67 shkrönja “i” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, me datën 26.02.2020 shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për propozim të anëtarit të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Vushtrri

I ftojmë të gjitha organizatat joqeveritare përkatësisht shoqërinë civile të Komunës së Vushtrrisë, që të propozojnë nga radhët e tyre një anëtar i cili do të jetë pjesë e komisionit vlerësues për zbatim të procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Vushtrrisë.

Është e preferueshme që kandidati i propozuar të jetë i caktuar në dakordancë në mes vet OJQ-ve, përkatësisht shoqërisë civile.

Personi i propozuar duhet plotësoj këtë kushte - kritere:

- Të jetë banorë rezident i Komunës së Vushtrrisë
- Të ketë diplomë universitare - e preferuar, drejtimi ekonomik, juridik.
- Të ketë përvojë të punës në fushën e administratës

Propozimit të kandidatit për anëtarë të komisionit vlerësues duhet bashkëngjitur:

- CV e shkurtër
- Kopje e dokumentit të identifikimit
- Kopjen e diplomës universitare
- Dëshminë për përvojën e punës

Afati i fundit për dorëzim të propozimit është data 12.03.2020.

Propozimi me shkrim me dokumentacionin e kërkuar duhet të dorëzohet në zyrën pritëse të Komunës, drejtuar Kryetarit të Komunës, ose, në E-mail: haki.maloku@rks-gov.net

Vendimin për emërim të anëtarit të propozuar në komisionin e ankesave do ta merr Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Propozimet e arritura pas këtij afati nuk do të merren në shqyrtim.

Për çdo sqarim shtesë, mund të kontaktohet çdo ditë pune zyrtari kontaktues në nr. tel. 044/272577 nga ora 8;30 deri në ora 15;30

